

VENDIM
Nr. 638, datë 15.11.2023

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2023, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT, PËR BASHKINË POGRADEÇ, PËR
FINANCIMIN E TARIFËS SË PJESËMARRJES PËR ORGANIZIMIN E
AKTIVITETIT NDËRKOMBËTAR “KAMPIONATI BOTËROR I FORMULA 1
H₂O”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 4, të nenit 25, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, i shtohet fondi prej 106 000 000 (njëqind e gjashtë milionë) lekësh në programin “Zhvillimi i sportit dhe rinisë”, për Bashkinë Pogradec, për financimin e vlerës së tarifës së pjesëmarrjes “*Staging fee*” për realizimin e aktivitetit ndërkombëtar “Kampionati Botëror i Formula 1 H₂O”.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i transferohet njësisë së vetëqeverisjes vendore, Bashkia Pogradec, nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në formë transferte, llogaria ekonomike 604.

3. Bashkia Pogradec kryen pagesën e tarifës së pjesëmarrjes për realizimin e aktivitetit ndërkombëtar “Kampionati Botëror i Formula 1 H₂O”, sipas akteve të saj të angazhimit, pasi të ketë administruar dokumentacionin e nevojshëm që garanton zhvillimin e aktivitetit dhe financimin e plotë të tij nga organizatorët.

4. Efektet financiare, në shumën prej 106 000 000 (njëqind e gjashtë milionë) lekësh, përballohen nga fondi rezervë i buxhetit, i miratuar për vitin 2023.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Bashkia Pogradec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku